



E Ngarkuara e Qeverisë Federale
për Migracionin, Refugjatët
dhe Integrimin

ÇFARË DUHET TË DINI TANI MBI KORONAN

Këshilla për sjelljen, kodi i punës dhe rregullat
në lidhje me udhëtimin me një shikim

Këtu gjeni
informacione mbi App
paralajmërues të koronas së
qeverisë federale në gjuhën
Tuaj amtare.



[www.integrationsbeauftragte.de/
corona-warn-app](http://www.integrationsbeauftragte.de/corona-warn-app)

E rëndësishme:
Me një vaksinë kundër
Koronas ju mbroni veten
dhe të tjerët



[www.integrationsbeauftragte.de/
corona-virus](http://www.integrationsbeauftragte.de/corona-virus)

Shëndeti




SI MUND TË MBROJ VETEN DHE TË TJERËT?

Të gjithë mund të ndihmojnë, për ta luftuar koronavirus. Mbajini kontaktet me njerëzit e tjerë mundësisht të vogla dhe kufizohuni në një rreth personash, i cili nuk ndryshon. Vetëm kështu mund të mënjanonin infektimin. Gjithmonë e rëndësishme:



Që të lani duart
(minimumi për
20 sekonda)



Mbani të 1,5 metra
distancë kundrejt
njerëzve të tjerë.



Mbani një mbulesë
për gojën dhe
hundën.



Kollitni ose teshtini
në këndin e bërrylit
ose në një façoletë.



Ajrosni mjaftueshë
ambientet e mbyllura.



PSE DUHET TË VAKSINOHEM KUNDËR KORONAVIRUSIT?

- Ju mbroni veten, të afërmit tuaj dhe personat e kontaktit.
- Vaksina është më dëshirë dhe falas. Në numrin e telefonit 116 117 informoheni se kur mund të vaksinoheni. Kjo linjë direkte telefoni është shumëgjuhëshe.
- Vaksinat janë të sigurta. Vaksinat janë kontrolluar me kujdes për sa i përket tolerancës, sigurisë dhe efektivitetit.



ÇFARË DUHET TË BËJ, NËSE BESOJ SE JAM INFEKTUAR?

Keni pasur kontakt personal me një person, te i cili u vërtetua që ishte i infektuar me koronavirus? Atëherë telefononi menjëherë zyrën tuaj lokale të shëndetit! Edhe atëherë, nëse nuk dallohen shenja të sëmundjes. Në numrin e telefonit 116 117 ju mund të informoheni se ku mund të testoheni. Deri sa të mbërrijë rezultati, ju qëndroni në shtëpi.

JETA PUBLIKE



ÇFARË VLEN NË HAPËSIRËN PUBLIKE?

Mbani një distancë minimale prej 1,5 m. Në vendet e mëposhtme duhet të mbani një maskë mjekësore: në transportin publik, gjatë kryerjes së blerjeve në vendet me qarkullim publik dhe vende të hapura me shumë njerëz. Ajo është e nevojshme edhe në vendin e punës, nëse nuk mund ta mbani në mënyrë të sigurt distancën 1,5 m.

Kujdes: Në rast mosrespektimi të detyrimit të mbajtjes së maskës, në të ardhmen mund të aplikohet një gjobë prej minimumi 50 Eurosh.



CILAT INSTITUCIONE JANË TË HAPURA?

- Dyqanet ushqimore, tregjet javore, floktoret dhe dyqanet e nevojave urgjente, ditore.
- Shërbimet e nevojshme mjekësore, për shembull fizioterapia, lejohen që të kryhen.
- Gjatë shërbesave dhe eventeve fetare duhen respektuar rregullat e higjienës dhe të distancës.
- Nëse e lejon situata e pandemisë në vend, duke filluar nga data 8 mars, landet federale mund të hapin dyqane, muze dhe kopshte zoologjike, nga data 22 mars edhe gastronomia në ambientet e jashtme.



ÇFARË VLEN PËR TAKIMET PRIVATE?

Mund të takohen maks. pesë persona nga dy familje të ndryshme (fëmijët deri në 14 vjeç nuk përfshihen), nëse e lejon situata e pandemisë në vend.

Në landet federale janë të mundura edhe rregulla të ndryshme, në varësi të situatës së pandemisë. Në rastin e shumë infeksioneve të reja, landet federale mund të kufizojnë p.sh. mundësitë e kontaktit. Në rastin e më pak infeksioneve të reja janë të mundura hapa të tjerë hapjeje. Informacione mbi këtë gjë ka në faqet e landeve.



Puna dhe paratë



ÇFARË NDODH, NËSE PUNËDHËNËSI IM E MBYLL AKTIVITETIN PËR MOMENTIN PËR SHKAK TË KORONAS?

Normalisht ju vazhdoni të posedoni të drejtën për tu trajtuar me pagë, edhe nëse ju nuk mund të punoni.

ÇFARË DUHET TË BËJ, NËSE NGELEM PA PUNË?

Në rast se ngeleni pa punë duhet që të regjistrohni në Jobcenter-in tuaj ose zyrën tuaj të punës. Jobcenter dhe zyrat e punës punojnë përsëri, por ato presin vizitorë vetëm në raste urgjente dhe duke caktuar takim. Ju mund të regjistrohni si i papunë me telefon, duke shkruar një letër ose online dhe ti parashtroni të gjitha kërkesat online. E rëndësishme është: Edhe gjatë kohës së koronas vlejnjë rregullat e mbrojtjes kundrejt pushimit nga puna. Përveç kësaj, aksesit tek të ardhurat bazë për personat në kërkim të një pune është thjeshtuar, p.sh. pa kontroll të ndërlikuar të pasurisë suaj.



ÇFARË NDODH, NËSE PUNËDHËNËSI IM KA URDHËRUAR PUNË ME ORAR TË SHKURTUAR?

Nëse punëdhënësi juaj ka urdhëruar në mënyrë të drejtë punën me orar të shkurtuar, atëherë deri në 24 muaj, ju mund të përfitoni pagesën për punën me orar të shkurtuar. Mund të jetë deri në 87% të pagës

tuaj të munguar. Nëse janë përmbushur të gjitha kushtet për pagesën e punës me kohë të shkurtuar, kontrollohet për çdo rast nga agjencia e punës.



ÇFARË NDIHMASH MUND TË MARR PËR NDËRMARRJEN TIME?

Instituti kreditor për rindërtim (KfW) ofron kredi të ndryshme të favorshme për ndërmarrjet. Ju lutemi drejtojuni bankës tuaj ose partnerëve të financimit, të cilët akordojnë kreditë e KfW. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat sigurojnë ose zgjerojnë ofertën e tyre me vende për arsim profesional, përfitojnë mbështetje financiare.

ÇFARË MBËSHTETJE MARRIN TË VETË-PUNËSUARIT ME NJË PERSON DHE BIZNESI I VOGËL?

Në dispozicion gjendet një program special i KfW me kushte të përshtatshme kreditimi, grante për shpenzimet operacionale, garanci me përfshirjen e qeverisë federale, masa ndihmëse fiskale ose një paketë mbështetëse për Start-ups. Mbështetje tjetër në rastin e rënies së xhiros të kushtëzuar nga korona ka për organizatat kulturore me financim privat si dhe për organizatat e bamirësisë, p.sh. për bujtinat e të rinjve, dyqanet sociale ose për ndërmarrjet gjithëpërfshirëse.



ÇFARË MBËSHETJE KA PËR STUDENTËT?

Studentët mund të kërkojnë në rastin e një emergjence financiare një grant pranë shërbimeve studentore. Ai përmban deri në 500 Euro në muaj. Përveç kësaj ekziston një kredi studimesh e KfW, edhe për studentët e huaj.



MUND TË PARASHTRON KËRKESËN PËR NJË SHITESË PËR FËMIJËT?

Nëse të ardhurat tuaja nuk mjaftojnë për të gjithë familjen, ekziston mundësia e një ndihme financiare. Në 2021 ju mund të përfitoni edhe 10 ditë pagesë shtesë, kur fëmijët janë sëmurë, për çdo prind (20 ditë, nëse ju e rrisni fëmijën e/i vetme/vetëm). Kjo vlen edhe në rastin kur ju duhet të kujdeseni për fëmijën tuaj në shtëpi, pasi shkolla ose kopshti janë mbyllur për shkak të pandemisë.



ÇFARË VLEN PËR UDHËTIMET?

Udhëtimet private dhe turistike brenda dhe jashtë vendit, të cilat nuk janë të domosdoshme, duhet që të vazhdojnë të mos kryhen. Mundësitë e akomodimit në Gjermani, p.sh. në hotele, lejohen vetëm për qëllime të domosdoshme – por jo për turizëm. Ju lutemi informohuni para udhëtimit tuaj në një vend të huaj pranë ministrisë së jashtme dhe pranë ministrisë së brendshme mbi kufizimet aktuale të udhëtimit dhe kontrollet në kufi.

ÇFARË DUHET TË KEM PARASYSH KUR TË KTHEHEM?

Për të gjithë, të cilët udhëtojnë nga një zonë rreziku për në Gjermani, vlen: Ju duhet që brenda 48 orëve para udhëtimit ose direkt më pas të bëni një test dhe të qëndroni në shtëpi! Mos prisni vizita dhe regjistrohuni menjëherë pranë zyrës vendore të shëndetit publik! Një test tjetër për koronën mund ta bëni më së pari pas ditës së 5-të pas kthimit, në

mënyrë që më pas, në rastin e një testi negativ, ta përfundoni para kohe karantinën (përndryshe 10 ditë). Se ku mund të testoheni e merrni vesh në numrin e telefonit 116 117.

Kujdes: Në rast mosrespektimi të detyrimit të karantinimit, do të gjyqiteni.

Në rastin e udhëtimit nga zona me incidencë të lartë ose me variante të tjera virusi zbatohen rregulla të rrepta dhe duhet të bëni një test para udhëtimit.

Shtetet që klasifikohen si zonë e rrezikshme, me incidencë të lartë ose me variante virusi i gjeni këtu: https://www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges_Coronavirus/Risikogebiete_neu.html



ÇFARË BËN QEVERIA?

Qeveria federale dhe landet vendosin në dispozicion më shumë se 1 bilion Euro si ndihma, për të zbutur pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë së koronës. Për ndërmarrjet dhe bizneset, të cilët janë të detyruar të mbyllën në Nëntor ose Dhjetor 2020, ka një program shtesë ndihme.



KU MUND TË GJEJ INFORMACIONE TË BESUESHME MBI KËTO TEMA NË GJUHË TË NDRYSHME?

Interneti është plot me thashetheme dhe fake news, të cilat përhapen me shpejtësi nëpërmjet chat-eve në grup. Informacione aktuale në gjuhë të ndryshme, të cilave ju mund ti zini besë, gjeni në:

www.integrationsbeauftragte.de/corona-virus dhe www.eu-gleichbehandlungsstelle.de/corona-virus.

Botuesi:

E Ngarkuara e Qeverisë Federale për Migracionin, Refugjatët dhe Integrimin;

Versioni:

08.03.2021



www.integrationsbeauftragte.de/corona-virus



www.eu-gleichbehandlungsstelle.de/corona-virus